

Të dhënat bazike për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Metodikë me punë praktike
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III (semestri i pestë)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	E enjtë 11:00-13:15 salla P5
Mësimdhënësi i lëndës:	Linda Salihu, Ligjëruese
Detajet kontaktuese:	linda.salihu@uni-pr.edu zyra 4
Përshkrimi i lëndës	<p>Kjo lëndë do t'ju japë mundësi studentëve për zbatimin e ideve didaktiko-metodike dhe njohurive të tyre teorike për nxënien dhe mësimdhënien në mjediset reale shkollore. Ajo ofron qasje fundamentale metodike për asistimin e mësimdhënësve në procesin e dizajnit, strukturimit, planifikimit dhe organizimit të aktiviteteve mësimore për të gjithë nxënësit. Shumë mësimdhënës të shkollave në Kosovë punojnë me klasa të mbingarkuara dhe në mjedise pa përkrahje. Ata kanë nevojë për ndihmë praktike në dizajnimin e aktiviteteve për nxënësit e tyre, duke marrë për bazë (1) <i>rezultatet e synuara</i>, të përkufizuara në kuptim të njohurive, shkathtësive, kompetencave kurrikulare dhe përparimit të pritur; (2) <i>grupin e nxënësve</i>, të përkufizuar në kuptim të nevojave, përvojave të mëparshme, pritjeve, shkathtësive dhe kompetencave të nxënësve; dhe (3) <i>mjedisin mësimor</i>, të përkufizuar në kuptim të burimeve njerëzore dhe mjeteve fizike e digjitale. Prandaj hapi më i rëndësishëm në procesin e mësimdhënies është planifikimi paraprak i tij, i menduar mirë dhe me kujdes. Ai ju siguron profesionistëve arsimorë jo vetëm që t'i arrijnë rezultatet e të nxënësve të parapara në kurrikulën shkollore, por që të realizojnë potencialin e plotë dhe të vërtetë të secilit nxënës.</p>
Qëllimet e lëndës	<p>Qëllimi i kësaj lënde është që t'ju mundësojë dhe t'i aftësojë studentët për të bërë lidhjen në mes të teorisë pedagogjike dhe praktikës mësimore. Krahas absorbimit të koncepteve teorike didaktiko-metodike, qëllimi është që këto koncepte të përbrendësohen dhe të bëhen të qëndrueshme përmes zbatimit të tyre në klasat e zakonshme. Përvojat e fituara në mjediset shkollore do të shërbejnë si mjet për të menduar, reflektuar dhe nxitur studentët që të jenë të vetëdijshëm për qasjet metodike (metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit, procedurat, format e punës mësimore), aktivitetet inovative dhe</p>

	<p>praktikat më të mira mësimore të bazuara dhe të modifikuara sipas provave e dëshmimeve kërkimore. Për më tepër, përvojat praktike do t'i bëjnë studentët të kuptojnë se asnjë qasje, përkatësisht metodë nuk funksionon nejtë për secilin nxënës. Prandaj nevojitet një varg i metodave mësimore si dhe të qenit fleksibil, kritik dhe profesionist kreativ.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies	<p>Me përfundimin e lëndës pritet që studentët të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raportojnë në formë të shkruar për observimet lidhur me atë se çfarë në të vërtetë ndodh në klasë duke specifikuar rezultatet e të nxënës, procedurat, aktivitetet e implementuara dhe metodat e zbatuara; - Hartojnë një plan të detajuar për një njësi mësimore me të gjithë treguesit e kërkuar për implementimin e tij; - Parashikojnë problemet që mund të paraqiten si dhe hapat e ndërmarrë për t'u përballur me to kur plani zbatohet; - Reflektojnë dhe vlerësojnë për përvojat mësimore të fituara gjatë implementimit në mjediset reale shkollore duke dhënë arsyeshmërinë dhe argumentet për dhe/ose kundër nëse planet e dizajnuara kanë përmbushur objektivat e parapara të të nxënës (Ditari reflektiv); - Zhvillojnë një të kuptuar të ndjeshëm dhe një qëndrim pozitiv ndaj punës së kolegëve mësimdhënës dhe ndaj punës së tyre të ardhshme. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike në terren	3	10	30
Kontaktet me mësimdhënës/konsultimet	1	10	10
Kollokfiume, seminare	2	4	8
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	6	3	18
Përgatitja përfundimtare për provim	2	2	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	1	3
Projektet, prezentimet, etj	24	75	178
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Lënda do të zhvillohet përmes ligjëratave, diskutimeve, aktiviteteve në grupe të vogla dhe punës individuale. Ky do të jetë një mjedis i pasur akademik i dedikuar më tepër të nxënës përmes të bërit, sesa dhënies ekskluzive të leksioneve. Studentët do të jenë të angazhuar në diskutime interaktive të cilat planifikohen për reflektim, analizim dhe ndarje të përvojave të fituara gjatë</p>		

	praktikës shkollore.										
Metodat e vlerësimit:	<table> <tr> <td>Vijimi i rregullt në orët e mësimit</td> <td>10 pikë</td> </tr> <tr> <td>Pjesëmarrja aktive në mësim</td> <td>20 pikë</td> </tr> <tr> <td>Kollokvium</td> <td>20 pikë</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar (me shkrim)</td> <td>50 pikë</td> </tr> <tr> <td colspan="2" style="text-align: right;">Gjithsej: <u>100 pikë</u></td> </tr> </table>	Vijimi i rregullt në orët e mësimit	10 pikë	Pjesëmarrja aktive në mësim	20 pikë	Kollokvium	20 pikë	Provimi përfundimtar (me shkrim)	50 pikë	Gjithsej: <u>100 pikë</u>	
Vijimi i rregullt në orët e mësimit	10 pikë										
Pjesëmarrja aktive në mësim	20 pikë										
Kollokvium	20 pikë										
Provimi përfundimtar (me shkrim)	50 pikë										
Gjithsej: <u>100 pikë</u>											
Literatura											
Literatura bazë:	<p>Waring, M., & Evans, C. (2015). Understanding pedagogy: Developing a critical approach to teaching and learning. London: Routledge.</p> <p>Danielson, C. (2007). Enhancing professional practice: A framework for teaching. Alexandria VA: ASCD.</p> <p>Krasniqi, I., & Veseli, A. (2000). Metodika e mësimit të dituri natyrë e shoqërisë. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.</p> <p>Krasniqi, I. (2002). Mësimi i leximit dhe i shkrimit fillestar. Ndihmës metodik për studentët e mësuesisë, të Degës së Pedagogjisë dhe për mësuesit e klasës së parë të shkollës fillore. Prishtinë: Libri Shkollor.</p> <p>Musai, B. (2014). Metodologji e mësimdhënies: Arti dhe shkenca për të përgatitur nxënës të suksesshëm. Tiranë: CDE.</p> <p>Price, K. M., & Karna, N. L. (2010). Planning effective instruction: Diversity, responsive methods and management. Wadsworth Publishing.</p>										
Literatura shtesë:	<p>MAShT (2011). Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës. Prishtinë.</p> <p>Westwood, P. (2008). What teachers need to know about learning difficulties. Camberwell Vic.: ACER Press.</p>										
Plani i dizajnuar i mësimit:											
Java	Ligjërata që do të zhvillohet										
Java e parë:	Karakteri i qëllimshëm i mësimit Procesi i të nxënës dhe çuarja e tij përpara										
Java e dytë:	Planifikimi dhe përgatitja e mësimit Demonstrimi i njohurive për nxënësit (zhvillimi, njohuritë, shkathtësitë, interesat, nevojat e veçanta në të nxënë dhe për mësim)										
Java e tretë:	Përcaktimi i objektivave mësimore dhe rezultatet e pritura të nxënies										
Java e katërt:	Organizimi dhe zhvillimi i mësimit <ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet mësimore dhe bërja e detyrave • Materialet, burimet dhe mjetet mësimore • Struktura e orës së mësimit 										
Java e pestë:	Përdorimi i teknikës së të pyeturit dhe të diskutimit <ul style="list-style-type: none"> • Cilësia e pyetjeve • Teknikat e diskutimit 										

	<ul style="list-style-type: none"> • Angazhimi i nxënësve përmes pjesëmarrjes në procesin e të nxënësve • Sqarimet e përmbajtjeve (metodat, format dhe procedurat e punës mësimore)
Java e gjashtë:	Përdorimi i vlerësimit në mësim <ul style="list-style-type: none"> • Kriteret e vlerësimit • Mbikëqyrja e të nxënësve të fëmijëve • Informata kthyes (feedback-u) për nxënësit • Vetëvlerësimi dhe mbikëqyrja e përparimit nga ana e nxënësve
Java e shtatë:	Demonstrimi i fleksibilitetit dhe përgjigjes ndaj situatës <ul style="list-style-type: none"> • Përshtatja e njësive mësimore sipas nevojave të nxënësve të ndryshëm • Përgjigja dhe reagimi ndaj nevojave dhe interesave të nxënësve
Java e tetë:	Kollokviumi
Java e nëntë:	Krijimi i një mjedisi të respektit dhe reciprocitetit <ul style="list-style-type: none"> • Ndërveprimi i mësimdhënësit me nxënësit • Ndërveprimi i nxënësit me nxënësit tjerë • Përgjigja ndaj sjelljes së papranueshme të nxënësit
Java e dhjetë:	Organizimi i hapësirës fizike <ul style="list-style-type: none"> • Siguria dhe qasja • Rregullimi i orendive dhe përdorimi i mjeteve e burimeve fizike
Java e njëmbëdhjetë:	Përgjegjësitë profesionale: Reflektimi për mësimdhënien <ul style="list-style-type: none"> • Saktësia • Përdorimi në mësimdhënien e ardhshme • Përfshirja dhe angazhimi i familjeve në programet mësimore
Java e dymbëdhjetë:	Pjesëmarrja në komunitetin profesional <ul style="list-style-type: none"> • Marrëdhëniet me kolegët • Përfshirja në kulturën e kërkimit profesional
Java e trembëdhjetë:	Rritja dhe zhvillimi profesional <ul style="list-style-type: none"> • Shërbimi ndaj profesionit dhe ndaj shoqërisë
Java e katërbëdhjetë:	Manifestimi i profesionalizmit <ul style="list-style-type: none"> • Integriteti dhe sjellja etike • Shërbimi ndaj nxënësve • Avokimi • Vendimmarrja
Java e pesëmbëdhjetë:	Vështirësi retrospektive në çështjet kryesore të elaboruara; udhëzime për provimin përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Ardhja me kohë në orët e mësimin;
- Secilit student i lejoheq që të parashtrijë pyetje apo të bëjë komente kur i jepet fjala;
- Studentit nuk i lejoheq t'i ndërhyjë tjetrit kur ai apo ajo e ka fjalën;
- Ndalohet përdorimi i telefonave celularë për çështje private.